



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:119776

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05860180

Ac.nr.8800/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit Halide Reka dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: R.Sh, E.Sh, F.Xh-M, A.Sh dhe G.S, të gjitha nga V....., të cilat sipas autorizimit i përfaqëson zyra e avokatëve F.G dhe K.F, me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.759/2021, të datës 21.11.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.759/2021, të datës 21.11.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.759/2021, të datës 21.11.2022, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, R.Sh, E.Sh, F.Xh-M, A.Sh dhe G.S të gjitha nga V....., dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditësit R.Sh për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 702.00 euro, paditësin E.Sh për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494,00 euro, paditësve F.Xh-M për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494.00 euro, paditësit A.Sh për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494.00 euro dhe paditësin G.S për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t’ia paguaj shumën prej 494.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 11.06.2021 e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e*

përmbarrimit me detyrim, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë, për padi shumën prej 312.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 332.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim”.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, ashtu që të anulohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë kanë parashtruar paditësit, përmes të autorizuarit të tyre duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 11.06.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë punës, ndërsa me parashtrësën e datës 21.10.2022 ka plotësuar padinë, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve, në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, duke llogaritur ditët e pranisë në punë për periudhën kohore nga data 15.07.2019 deri me datën 15.03.2021 për paditësin R.Sh për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t'ia paguaj shumën prej 702.00 euro, paditësin E.Sh për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t'ia paguaj shumën prej 494,00 euro, paditësve F.Xh-M për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t'ia paguaj shumën prej 494.00 euro, paditësve A.Sh për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t'ia paguaj shumën prej 494.00 euro dhe paditësit G.S për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, t'ia paguaj shumën prej 494.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, dhe plotësimit të saj, jashtë seancës gjyqësore pas vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës në kuptim të nenit 398 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.759/2021, të datës 21.11.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas pranimi të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për

dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” si dhe vërtetimeve të lëshuara nga SHF dhe e Mesme e Ulet “.....”, Akrashticë Komuna V....., për paditësin R.Sh vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësin E.Sh vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësen F.Xh-M vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësin A.Sh vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësin G.S vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar, andaj edhe paditësit R.Sh i'a njohu shumën prej nga 702.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($351 \times 2 = 702$), paditësin E.Sh i'a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$), paditësve F.Xh-M i'a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$), paditësit A.Sh i'a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$) dhe paditësin G.S i'a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, ndërsa paditëset kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 15.07.2019 deri më 15.03.2021, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më 11.06.2021.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe të dt. 22.01.2021. Vendimi mbi kamatën është vendosur konform nenit 382 par. 2 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), se nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare, nuk ka paraqitur qartë se cilat arsye i trajton si të vërteta apo të pavërteta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendime të autorizuarit të paditurës janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku nga si dhe vërtetimeve të lëshuara nga SHF dhe e Mesme e Ulet “.....”, Akrashticë Komuna V....., për paditësin R.Sh vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësin E.Sh vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësen F.Xh-M vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësin A.Sh vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, për paditësin G.S vërtetim i datës 18.03.2021, për periudhën nga data 15.07.2019 e deri me datë 15.03.2021, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar, andaj edhe paditësit R.Sh i’a njohu shumën prej nga 702.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($351 \times 2 = 702$), paditësin E.Sh i’a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$), paditësve F.Xh-M i’a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$), paditësit A.Sh i’a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$) dhe paditësin G.S i’a njohu shumën prej 494.00 euro, duke përllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($247 \times 2 = 494$), duke iu njohur shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësve në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës, gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien*

e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij". Kjo për arsye se e paditura nuk ia ka paguar ushqimin ditor paditësve për ditët e pranisë në punë, ndërsa nga ana tjetër nuk ia ka siguruar ushqimin të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, andaj ka obligim kompensimin për ushqim paditësve.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës me ç'rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 përcaktohet se: *"1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut"*, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *"Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës"*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bien të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8800/2022, me datë 19.06.2024

Kryetare e kolegjit
Nora Billaca Dula, d.v.